



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 96, datë 5.2.2020

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.276, DATË 16.5.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MËNYRËS
SË ORGANIZIMIT, TË STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE STATUTIT
TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", dhe të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Numri i punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar është, gjithsej, 166 veta."

2. Në skemën 2, që përmendet në pikën 5, të kreut IV, bëhen këto ndryshime:

- a) Pozicionet "Specialist (IT)" në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, shfuqizohen;
- b) Numri i punonjësve të nënndarjes 5.3, "Sektori i Shërbimeve", bëhet 14 dhe numri i punonjësve të ndarjes 5, "Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme", bëhet 22;

c) Numri i punonjësve të Zyrës Qendrore të Autoritetit Rrugor Shqiptar bëhet, gjithsej, 112.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

NR.PROT. 687/1
DATË 6.2. 2020

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', is written over a blue circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKË SHQIPTARE' at the top and 'MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË' at the bottom, with a central emblem.